

RELACION

Projekti për objektin: "Ndërtim gabioni në lumin Osum" në zonën e Urës Vajgurore, Bashkia DIMAL, rrethi i Beratit, hartohet me synimin kryesor për të mbrojtur nga përmbytjet e lumit Osum të tokave bujqësore dhe objekte të tjera banimi apo sociale, që ndodhen në këtë zonë në krahun e majtë të rrjedhës së lumit në këtë zonë.

KONSTATIME GJATË INSPEKTIMIT NË TERREN

1. Të dhëna të përgjithshme

Pozicionimi.

Objekti që i nënshtrohet inspektimit ndodhet i pozicionuar në koordinata 489589,659, 4515282,331KRRGJSH në qytetin e Dimalit.

Të dhëna mbi objektin;

Lumi Osumit është degë kryesore e lumit të Semanit. Është quajtur më parë Lumi: Beratit. Ai është 161 km i gjatë, sipërfaqja ujëmbledhëse është 2.150 km, lartësia mesatare 828 m. prurja mesatare shumëvjeçare 32,5 m/s dhe rrjedhje të pakta prej 17.5 l/s/km².

Osumi kalon në zemër të qytetit të Beratit dhe te Dimalit. Në fund të rrjedhës së tij bashkohet me lumin Devoll ku bashkë krijojnë lumin Seman.

Mbi lumin e Osumit në pjesën që kalon në bashkinë e Dimalit ka të ndërtuar dy ura njëra është pjesë e zonës urbane të qytetit dhe tjetra ure automobilistike në aksin kombëtar rrugor. Përgjatë lumit ka të ndërtuara argjinatura me material vendi dhe disa vende të veshura të cilat shërbejnë për mbrotjen nga përmbytjet. Në të dyja anët e lumit në këtë zonë ka të ndërtuara mbrojtje me gurë të veshura me rrjeta gabioni dhe mbilartësim kurore të argjinaturës për të mos lejuar përmbytjen e zonave fushore përreth. Në vitin 2017 ka patur një prurje të madhe të lumit në këtë zonë e cila në një farë mënyre ka testuar dhe argjinaturen për qëllimin e ndërtimit të saj.

Për ndërtimin e urës nga kompania ndërtuese janë krijuar dy bazamente me gure të cilat kanë shërbyer për vendosjen e mjeteve ngritëse të cilat kanë bërë të mundur montimin e traut te ures. Krijimi i ketyre bazamenteve me gure ka sjellë si rrjedhojë ngushtimin e shtratit të lumit duke krijuar premisa për rritjen e nivelit të tij. Lumi në pjesën ku po ndërtohet ura ka nje kthese të lehtë djathtas rrjedhës së tij. Ngushtimi i shtratit nga bazamenti me gurë ka sjellë një devijim të rrymës së lumit duke e drejtuar atë në pjesën ballore të kthesës në anën e djathtë të rrjedhës. Si rrjedhojë nga ndikimi i prurjeve të lumit gjatë muajve të fundit është dëmtuar skarpata e argjinaturës e cila ka qënë me material vendi dhe me bimësi dhe shkurre të madhësive të ndryshme. Dëmtimi ka arritur deri në argjinaturën me gabiona me gurë të vendosur në një nivel të lartë dehe në largësi rreth 3-4m nga shtrati i lumit.

Në një pjesë të shtratit të lumit Osum në afërsi të urës së re këmbësore që është në ndërtim ka shkarje të theksuar së formacionit të dheut duke zbuluar tërësisht gabionin mbajtës në një

gjatësi gati 60ml. Në këtë gjatësi vihen re burime të shumta nëntoksore, të cilat kanë dal në pah pas shkarjes së dheut. Rrëshkitja vazhdon të avancojë me nisjen e reshjeve të shiut. Vlera e dëmit të shkaktuar nga kjo rrëshkitje është dëmtimi i gabionit i vlerësuar sipas manualit 3 të cmimeve të vitit 2015:

$60*1*1*3 \times 5459 = 982620$ lekë.

Parashikohet të stabilizohet situata duke hedhur në shtratin e lumit gurë kave të cilët ulin efektin e erozionit dhe gërryerjes, dhe sipër gurëve do të vendosen gabione të shkallëzuar.



Burime të dukshme nëntokësore



